

VENDIM
Nr. 141, datë 13.2.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E AKTIVITETEVE, TË KRITEREVE DHE TË
PROCEDURAVE PËR PERSONAT JURIDIKË QË USHTROJNË VEPRIMTARI
EKONOMIKE NË INDUSTRIJË AUTOMOTIVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 28, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Përcaktimin e aktiviteteve, të kriterëve dhe të procedurave për tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtari ekonomike në industrinë automotive, të cilët aplikojnë shkallën e tatimit mbi fitimin në masën 5%, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

1. Aktivitetet që përfshihen në industrinë automotive

Për qëllim të zbatimit të shkallës 5% të tatimit mbi fitimin, në industrinë automotive përfshihen tatimpaguesit që janë të regjistruar si të tillë dhe kryejnë aktivitetet e prodhimit të mjeteve motorike ose të pjesëve përbërëse të tyre.

Kjo industri nuk përfshin tatimpagues që kryejnë aktivitete për mirëmbajtjen e mjeteve motorike apo shërbime të tilla si riparimet.

2. Kriteret dhe procedurat për aplikimin e tatimit nga personat juridikë që ushtrojnë këto aktivitete:

a) Personi juridik, për të zbatuar shkallën tatimore të përcaktuar në pikën 5, të nenit 28, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, duhet:

i. të ketë përcaktuar në objektin e veprimtarisë së njësisë ekonomike aktivitetet ekonomike të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi;

ii. të realizojë jo më pak se 100% të qarkullimit vjetor në aktivitetet ekonomike të parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi;

iii. të ketë të punësuar mesatarisht gjatë vitit financiar jo më pak se 250 (dyqind e pesëdhjetë) punonjës.

b) Personi juridik, i cili kryen aktivitetet sipas pikës 1 të këtij vendimi dhe plotëson kriteret e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 2, të këtij vendimi, aplikon shkallën tatimore të përcaktuar në pikën 5, të nenit 28, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.

Personi juridik paraqet pranë drejtorisë rajonale tatimore përkatëse një deklaratë me shkrim, ku tregon plotësimin e kriterëve sipas këtij vendimi.

c) Personi juridik, i cili aplikon shkallën tatimore prej 5 (pesë) %, sipas pikës 5, të nenit 28, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, duhet të zhvillojë vetëm veprimtari të fushës së industrisë automotive, sipas pikës 1 të këtij vendimi. Nëse personi juridik zhvillon edhe veprimtari të tjera ekonomike, ai duhet të regjistrohet si subjekt tatimor më vete.

II. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama